



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1132/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Rivotim për Kryetarë të Komunës së Istogut të Zgjedhjeve Lokale të datës 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.12.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog e cila identifikohet me numër ZL.Anr.1132/2017 e datës 17.12.2017.

### A r s y e t i m

Me datën 17.12.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendon se në fshatin Kaliqan, Komuna e Istogut në vendvotimin 0621C/02D janë vërejtur parregullsi në Librin e Votimit, ku janë evidentuar me laps të thjeshtë votuesit dhe personat në asistencë për të votuar, vëzhguesit nga radhët e subjektit politik LDK kanë bërë parregullsi në mënyrë të qëllimshme. Andaj nga PZAP ka kërkuar që të hapet kutia e votimit dhe të hetohet ky vendvotim. Parashtruesi i ankesës për të vërtetuar pretendimet e tij ka bashkangjitur një koment të Organizatës Joqeveritare Demokracia në Veprim, e postuar në portalin e Gazetes Express.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në Librin e Votimit janë evidentuar me laps të thjeshtë votuesit dhe personat me asistencë për të votuar, Paneli pas verifikimit në Librin e Votimit për Vendvotimin 0621C/02D, ka konstatuar se të gjithë votuesit janë evidentuar me laps kimik, poashtu paneli ka konstatuar se nuk ka pasur parregullsi në ditën e votimit, pasi që në vendvotimin e cekur më lartë votimi ka filluar në mënyrë të rregullt në ora 07:00 dhe ka përfunduar poashtu në mënyrë të rregullt në ora 19:00, dhe se nuk është evidentuar ndonjë parregullsi me çka konstatohet nga Libri i Votimit për Vendvotimin 0621C/02D, me të cilin libër nuk është evidentuar asnjë vërejtje nga asnjë komisioner apo nga ndonjë vëzhgues që ka qenë prezent gjatë gjithë ditës së votimit.

Ndërsa lidhur me pretendimet për hapjen e kutisë së votimit 0621C/02D, paneli nuk ka gjetur asnjë arsye për të hapur kutinë e votimit, ngase siç u konstatua më lartë nuk është evidentuar asnjë parregullsi gjatë ditës së votimit, prandaj edhe pretendimi për hapjen e kësaj kutie të votimit është i pa qëndrueshëm, sepse pretendimet e parashtruesit të ankesës nuk i ka argumentuar me asnjë provë shkresore.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL. Anr.1132/2017 më datën 19.12.2017.



**Kryesues i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**

**Këshillë juridike:** Në bazë të nenit 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*